

**Hulumtim  
mbi  
qëndrimet  
e shoqërisë  
kosovare  
ndaj  
homoseksualitetit**







**Libertas**

**Hulumtim mbi qëndrimet e shoqërisë kosevare  
ndaj homosksualitetit**

**Hulumtim kuantitativ dhe kualitativ i opinioneve të qytetarëve  
të Kosovës**

**Dhjetor 2012**

**Hulumtimin e realizoi Qendra për studime humanistike  
“Gani Bobi”**

**Mbështetur nga Civil Rights Defenders**

**Dizajni: DZG**





## **Përshkrimi i mostrës**

Ky hulumtim, anketa në teren dhe biseda në fokus grup, është realizuar në fund të dhjetorit të vitit 2012.

Gjithsejt janë realizuar 755 anketa, prej tyre janë ndërtuar 3 mostra. E para ishte reprezentative prej 686 të të anketuarëve ku ata serbë dhe të minirriteteve të tjera janë llogaritur në përqindjet reale sa janë prezantet në strukturën demografike të Kosovës. Mostra e dytë ka qenë ajo e shqiptarëve, si etni dominante në Kosovë e përbërë prej 623 e të anketuarëve. Mostra e tretë është ajo e të anketuarëve të komuniteteve minoritare, që janë anketuar me kuota shtesë, që i janë shtuar mostrës bazë, në mënyrë që opinionet e kësaj kategorie të janë me frekuencë pak më relevante se që do të ishin nëse do të mbeteshin në kuotën prej diku 8 deri 10% të totalit, pra rrëth 80 të anketuar.

Anketimi është bërë në tërë territorin e Kosovës, në 28 komuna, që nuk është numri i plotë i tyre, por janë bërë disa shkurttime duke lënë anash zonat rrëth qendrave të mëdha nga një komunë, ku kemi supozuar se kjo nuk do të dëmtojë reprezentativitetin e opinioneve për tërësinë.

Përpos anketës kemi realizuar edhe një bisedë në fokus grup me përfaqësuesit e disa kategorive të të rinjve. Fillimisht, fokus grupei është dashur të përbëhet nga pjesëtarët e komunitetit LGBT, por pasi që biseda ishte caktuar në kohën kur ende kishte tensione pas incidenteve dhe sulmeve që ndodhën ndaj komunitetit LGBT me rastin e promovimit të revistës Kosovo 2.0 dhe të organizatës Libertas, grupei që ishte përzgjedhur nuk ndiente mjaft siguri që të paraqitej në këtë lloj bisede ku pos tyre do të ishin edhe disa persona teknikë dhe ekspertë që do të realizonin këtë pjesë të hulumtimit. Andaj ky grup është zëvendësuar me grupin e studentëve.

## **Pyetësori dhe treguesit kryesorë**

Pyetësori i këtij hulumtimi, pos pjesës demografike, përmبante edhe disa pyetje që në shikim të parë nuk kanë të bëjnë aspak me temën por, megjithatë, na kanë shërbyer për identifikimin e disa aspekteve të stratifikimit shoqëror dhe të bindjeve në qëndrimet e kosovarëve për komunitetin LGBT. Iшин këto pyetje për standardin jetësor, përkatësitë fetare dhe partiake (për kë votojnë), si dhe për disa çështje kyçë për orientimin e Kosovës dhe kosovarëve, p.sh. qëndrimi ndaj Perëndimit, ndaj integrimit të Kosovës në BE si dhe vlerësimi i zhvillimit të demokracisë në Kosovë.

Pos këtyre, e kemi shtruar pyetjen se çfarë i mungon sot rinasë kosovare, a duhet të kenë më shumë liri nga shtrëngesa, si tregues i botëkuptimit liberal

dhe anti-autoritar, apo përkundrazi, rinasë kosovare i mungon më shumë disciplina dhe rendi, si tregues i botëkuptimit konservator dhe autoritar.

Kryqëzimet e këtyre pyetjeve-tregues me pyetjet e drejtpërdrejta mbi çështjet e përgjithshme dhe të posaçme të komunitetit LGBT në Kosovë, na kanë mundësuar që të bëjmë disa tabela dhe grafikone që pasqyrojnë shkaqet e distancës shoqërore mjافت të lartë të kosovarëve ndaj komunitetit LGBT.

Përgjithësisht, shoqëria kosovare nuk ka perceptim racional dhe tolerant ndaj homoseksualitetit si realitet shoqëror që shumicës i duket i papëlqeshëm sepse ndajnë botëkuptime kryesish tradicionale, patriarchale dhe autoritare të bazuara në stereotipet dhe paragjykimet e zakonshme, të cilat përndryshe nuk janë karakteristikë vetëm e shoqërisë kosovare, por janë të përhapura, në shkallët e ndryshme, edhe në botë.

## Shënimet demografike për mostrën

GJINIA	%
Femra	45.4
Meshkuj	54.6

MOSHA	%
15-19	7.5
20-29	35.3
30-39	20.3
40-49	16.4
50-59	11.1
Mbi 60	9.4

PROFESIONI	%
Bujk	3.8
Punëtor i pakualifikuar	10.2
Punëtor i kualifikuar	14.1
Nëpunës i administratës	2.0
Ndërmarrës privat	7.3
Punëtor në arsim	3.6
Drejtor / menaxher	2.0
Gazetar / artist / politikan	0.1
Pensionist	3.3
Student	25.0
Amvise	16.8
SHPK / TMK	0.6
Tjetër	11.2
Total	100.0

## Shënimet demografike për mostrën

EDUKIMI	%
Pa shkollë	1.1
1-4	1.7
5-8	14.1
9-12	34.0
13-14	22.9
16-16	21.6
Mr	3.7
Spec.	0.6
Dr	0.3
Total	100.0

KOMBËSIA	%
Shqiptar	89.1
Serb	6.2
Mysliman	0.3
Bosnjak	1.0
Goran	0.1
Turk	1.0
Ashkali	1.1
Rom	0.7
Egjiptian	0.4
Total	100.0

## Konteksti

Kohëve të fundit në shoqërinë kosovare, kryesisht në media, por edhe nivele të caktuara institucionale, është hapur një debat i madh për çështjen e homoseksualitetit. Ky debat erdhi si rezultat i një ngjarjeje që ndodhi në Prishtinë, në dhjetor të vitit 2012. Ngjarja kishte të bënte me promovimin e revistës Kosovo 2.0, e cila në numrin e saj të rradhës kishte temë qëndrore seksin ose seksualitetin, dhe botëkuptimet apo perceptimet që ekzistojnë rreth tij në shoqërinë kosovare, por edhe më gjërë. Ky promovim u shndërrua në një situatë të dhunshme kur u pengua me forcë nga një lëvizje radikale dhe fundamentaliste nën akuzën se në atë revistë po promovohej homoseksualiteti, që sipas tyre ishte një dukuri e pamoralshme që fyente moralin dhe traditën kosovare. Pastaj para Pallatit të Rinisë u mbajtën edhe protesta në të cilat u desh të ndërhynë policia. Një ditë më vonë një vajzë ishte rrahur brutalisht para selisë së organizatës Libertas.

E tërë kjo nxiti një debat shumë të nxehjtë publik rreth homoseksualitetit dhe homofobisë. Në këtë debat ishin të përfshirë dy palë, njëra kryesisht e provinjencës fetare që është kundër homoseksualitetit me arsyetimin se praktika homoseksuale është e pamoralshme dhe antifetare dhe pala tjetër që e shikon këtë praktikë si legitime dhe pjesë të lirive individuale e të drejtave të njeriut.


Përveç këtyre dy palëve, në debatin në fjalë mund të dallohej edhe qëndrimi konzervativ patriarkal, i cili nuk mund të futet në kuadrin e reagimit të organizatave fetare. Ky qëndrim patriarkal është homofob, mirëpo prejardhja e tij lidhet me mentalitetin etnocentrik, sipas të cilit "tradita kombëtare shqiptare nuk pranon praktika si homoseksualiteti". Në këtë perspektivë, qëndrimi homofobik arsyetohet me idenë se "ne si popull jemi kundër homoseksualitetit, jo pse jemi mysliman, por sepse jemi shqiptarë".

Hulumtimi ka pasur për qëllim të identifikojë disa fakte mbi shpërndarjen e këtyre qëndrimeve në shoqërinë kosovare

## Njohuritë dhe qëndrimi i përgjithshëm ndaj homoseksualitetit

Duket se debati mbi homoseksualitetin, i cili është ndezë kohë pas kohe nga veprimtaritë e organizatave për mbrojtjen e të drejtave të komunitetit LGBT dhe së fundi pas incidenteve që ndodhën në muajin dhjetor të vitit të kaluar në qendrën e rinisë në Prishtinë, ka pasur një efekt në ngritjen e nivelit të informimit, nëse jo të njohurive, të qytetarëve të Kosovës mbi këtë fenomen të jetës shoqërore.

Kështu, në pyetjen drejtuar të të anektuarëve mbi njohuritë rreth çështjes së homoseksualitetit, në nivel të Kosovës 71.7 përqind janë deklaruar se kanë njohuri mbi këtë çështje. Në aspektin e dallimeve ndëretnike 71.9 përqind e të anketuarëve shqiptarë e japid këtë përgjigje, ndërsa nga të anketuarit prej komuniteteve në kuotën prej 68.2 përqind.



### **1. Informimi mbi ekzistimin e ligjeve që mbrojnë të drejtat e komunitetit LGBT**


Ky grafikon tregon se debati ka depërtuar te pothuajse të gjitha nivelet e shoqërisë kosovare, edhe te grupet etnike që e përbëjnë këtë shoqëri.

## Njohja personale e homoseksualëve

Një aspekt i rëndësishëm i njohjes së problemeve dhe çështjeve me të cilat ballafaqohen pjesëtarët e komunitetit LGBT është ai i njohjes personale që qytetarët mund të (mos) kenë me këta pjesëtarë. Indikatori që nxjerr humtimi është ky: në nivel të Kosovës, 86.3 përqind e të anketuarëve janë deklaruar se nuk njohin persona të komunitetit LGBT. Kjo përqindje është edhe më e lartë te të anketuarit shqiptarë (88.3%), dhe më e ulët te pakicat (71.9%).

cat (67.4%). Te këto të fundit vërehet një njohje më e madhe personale me pjesëtarët e komunitetit LGBT (22.7%).

Tregues të tillë mund të shpjegohen me faktin se në shoqërinë kosovare çështja e homoseksualitetit vazhdon të jetë shumë e ndjeshme, e ngarkuar me stereotipe të fuqishme, të cilat i bëjnë njerëzit të mohojnë çdo lloj përveç shoqërore me pjesëtarët e komunitetit në fjalë.




2. Njohja personale e pjesëtarëve të komunitetit LGBT

## Përse dikush është homoseksual?

Debati i zhvilluar në Kosovë mbi homoseksualitetin, përveç tjerash, ka prekur edhe dimensionin e prejardhjes së kësaj dukurie, nëse është dukuri e lindur dhe e përcaktuar nga vetë natyra, apo produkt i rrëthinës shoqërore në të cilën jeton individi me orientim homoseksual, ose në anën tjetër një çështje mode shoqërore?

Në Kosovë, 39.9 përqind e të anketuarëve kanë vlerësuar se kjo dukuri është e lindur. Te të anketuarit shqiptarë, një mendim të tillë e ndajnë 42.4 përqind, ndërsa te pakicat dukshëm më pak, 25.8 përqind. Ndërkaj, 28.4 përqind në nivel të Kosovës, 28.4 përqind nga të anketuarit shqiptarë, dhe 24.2 përqind nga ata të pakicave konsiderojnë se homoseksualiteti është produkt i rrëthit shoqëror.

Nga kjo shihet se pikëpamja mbi prejardhjen natyrore të homoseksualitetit është dukshëm më e përhapur, sidomos te shqiptarët. Te pakicat ndërkaq dominon opinioni i mosnjohurisë mbi këtë çështje (41.7%).



### 3. Pse është dikush homoseksual?


Shpeshherë në opinionin publik qarkullon ideja se e ashtuquajtura “sjellje homoseksuale”, më shumë se orientim i lindur natyror, ose efekt i ambientit shoqëror, është një praktikë shoqërore që ka tiparet e modës kulturore. Një përqindje e konsiderueshme e të anketuarëve e kanë këtë pikëpamje: në Kosovë, 18.4 përqind, te të anketuarit shqiptarë 19.6 përqind, e dukshëm më pak te pakicat, 8.3 përqind.

### Mbi “prejardhjen” e veçantë perëndimore të homoseksualitetit

Me kontekstin e kësaj pikëpamje është e ndërlidhur edhe një ide e cila qarkullon shumë në opinionin e gjërë publik, se homoseksualiteti dhe çështja e komunitetit LGBT në Kosovë është problematizuar dhe tematizuar nga presioni i vendeve perëndimore.

Kjo pikëpamje ka një përkrahje të gjërë në nivelin e Kosovës (68.3%), te shqiptarët (67.8%) dhe ende më të lartë te pakicat (70.4%).


Një gjë e tillë mund të shpjegohet me faktin se vendet perëndimore kanë një nivel të lartë të liberalizimit dhe afirmimit të të drejtave të komunitetit LGBT dhe një gjë e tillë natyrshëm shikohet si shkak i tematizimit të homoseksualitetit në shoqërinë kosovare, e cila aspiron të bëhet pjesë e bashkësisë së këtyre vendeve.



4. Komuniteti LGBT është bërë problem për shkak të presionit nga vendet perëndimore

#### “Fshchja” dhc “shfaqja” e homoseksualitetit

Karakteri i fuqishëm patriarchal e tradicional i familjes dhe shoqërisë kosovare në përgjithësi ka përcaktuar faktin e shndërrimit të fenomenit shoqëror të homoseksualitetit në një tabu të madhe.



5. Dikur homoseksualiteti është fshehur, sot shfaqet hapur

Kjo tabu ka nënkuptuar dy gjëra: heshtjen shoqërore të këtij fenomeni dhe, në rastet kur ai shfaqet, edhe fshehjen e tij. Ky kod i heshtjes dhe i fshehjes, viteve të fundit ka filluar disi të lëkundet.

Kësisoj, 57.7 përqind e të anketuarëve në nivel të Kosovës konsiderojnë se homoseksualiteti që dikur fshihej, tani shfaqet hapur. 56.2 përqind e të anketuarëve shqiptarë dhe 70.5 përqind e të anketuarëve nga pakicat e ndajnë një mendim të tillë. Ky tregues mund të vijë nga ekzistensa e një dinamike ndryshimi brenda strukturave rigjide tradicionale të shoqërisë kosovare.

## **Opinionet negative dhe pozitive të kosovarëve ndaj homoseksualitetit**

### **Pajtimi me qëndrimet negative ndaj homoseksualëve**

Debati publik i zhvilluar kohëve të fundit në Kosovë mbi homoseksualitetin ka evidentuar një nivel të lartë të homofobisë në shoqërinë kosovare, edhe pse formalisht pjesëtarët e komunitetit LGBT i gjelqjnë të drejtat dhe liritet individuale të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me Ligjin kundër diskriminimit, në jetën reale shoqërore ata ndeshen me praktika agresive të diskriminimit, kudo që shfaqen.

(MOS)PAJTIMI ME DEKLARIMET NEGATIVE MBI HOMOSEKSUALITETIN		PO	JO
1. Homoseksualiteti është sëmundje	47.6	30.1	
2. Homoseksualiteti rrezikon shoqërinë	61.6	20.7	
3. Nuk me pengon një person gej nese i tillë është në jetën private	35.9	47.9	
4. LGBT duhet të ndalojen me ligj dhe të ndëshkohen	50.6	22.0	
5. Idenë e mbrojtjes së komunitetit LGBT e ka krijuar Perëndimi për të shkatërruar familjen dhe traditën tonë	36.9	30.3	
6. Në asnjë rrëthanë nuk do të shoqërohesha me personat gej/lezbike	45.9	28.6	
7. Martesat mes dy personave të gjinisë së njëjtë nuk duhet të lejohen në asnjë rrëthanë	57.3	20.7	

Hulumtimi ka evidentuar një shkallë të lartë të qëndrimeve të ashpra negative ndaj pjesëtarëve të këtij komuniteti. Këto qëndrime luhaten nga ato ku konsiderohet se homoseksualiteti është sëmundje (47.6%) deri tek ato që konsiderojnë se ky fenomen është i rrezikshëm për shoqërinë (61.6%). Si rezultat i këtyre qëndrimeve, të anketuarit janë të mbështetje të politikave të ashpra si ndalimi me ligj dhe ndëshkimi i personave LGBT (50.6%), ose ndalimi i martesave të gjinisë së njejtë (57.3%).

Një tolerancë ndaj pjesëtarëve të komunitetit LGBT pranohet vetëm nëse personat LGBT janë të tillë në jetën e tyre private (35.9%), por jo edhe nëse ata e shprehin publikisht orientimin e tyre (47.9%). Dëbimi nga sfera publike është i lidhur edhe me mospranimin e të anketuarëve që të shoqërohen me persona homoseksualë në asnjë rrethanë (45.9%).

Në kontekst të krejt kësaj është i dukshëm edhe opinioni se idenë për mbrojtjen e komunitetit LGBT e ka krijuar perëndimi për të shkatërruar familjen dhe traditën tonë (36.9%). Ky opinion, me gjasë lidhet me qëndrimet kritike ndaj shoqërisë perëndimore, që kryesisht janë të prejardhjes së islamizmit radikal, qarqet e të cilit janë shumë aktive viteve të fundit në shoqërinë kosovare.

Mirëpo, ky opinion duhet të jetë pjesërisht edhe jehonë e konfrontimeve ndërmjet qarqeve liberale dhe konservatore në botën perëndimore rreth çështjes së legalizimit të martesave mes personave të gjinisë së njëjtë dhe atë të lejimit të adoptimit të fëmijëve nga çiftet homoseksuale. Promovimi medial i fuqishëm i debateve perëndimore, që përcillen edhe me protesta, po krijon përshtypjen në opinionin e Kosovës se kemi të bëjmë me çështje që po i tematizon ekskluzivisht Perëndimi. Kjo nuk konsiderohet si çështje e zgjërimit të spektrit të të drejtave të njeriut dhe të demokratizimit të shoqërisë, por si pjesë e kulturës së veçantë perëndimore, e cila në sytë e atyre që kujdesen për "traditën dhe vlerat tona kombëtare", merr trajtën e një debati të huaj i cili "nuk na përket neve" dhe që nuk mund të përshtatet me "traditën dhe kulturën tonë". Këtu flitet për shoqërinë kosovare, ose shqiptare dhe për komunitetet tjera që jetojnë në Kosovë, e që këtë traditë të veçantë e konceptojnë edhe aktualisht në përmasa homofobe.

## **Pajtimi me qëndrimet pozitive ndaj homoseksualitetit**

Hulumtimi ka prekur edhe çështjen e vlerësimit nga të aketuarit e qëndrimeve pozitive ndaj pjesëtarëve të komunitetit LGBT. Njëri prej këtyre qëndrimeve është se personat LGBT janë njerëz sikur gjithë të tjerët. 62.7 përqind e të anketuarëve e aprovojnë një qëndrim të tillë.

(MOS)PAJTIMI ME DEKLARIMET POZITIVE  
MBI HOMOSEKSUALITETIN

	PO	JO
1. Homoseksualët lindin të tillë	40.7	35.4
2. Personat LGBT janë njerëz sikur gjithë të tjerët	62.7	25.1
3. Dikur homoseksualiteti fshihej, ndërsa sot flitet për të dhe shfaqet hapur	57.7	19.4
4. Homoseksualiteti ka ekzistuar gjithmonë	36.1	25.0
5. Nuk kam problem të shoqërohem me persona LGBT edhe pse vetë nuk i takoj këtij grupi	24.0	51.7
6. Personave LGBT duhet t'u lejohet adoptimi i fëmijëve	7.1	72.3
7. Personat LGBT duhet t'i kenë të drejtat e njëjta sikur çdo qytetar tjetër	37.9	28.4

Një përqindje e theksuar e të anketuarëve konsiderojnë se homoseksualët lindin të tillë (40.7%), se homoseksualiteti ka ekzistuar gjithmonë (36.1%), dhe se dikur fshihej, por sot flitet dhe shfaqet hapur për të (57.5%).

Shumica nuk e aprovojnë qëndrimin se shoqërimi me persona të komunitetit LGBT është një shoqërim krejtësisht normal (51.7%) dhe poashtu shumica prej 72.3% e kundërshtojnë mendimin se personave LGBT duhet tu lejohet adoptimi i fëmijëve. Të pajtimit me adoptimin janë vetëm 7.1%, kurse të padeklaruar 21.6%.

Qëndrimi tjetër pozitiv ndaj homoseksualëve është se ata duhet t'i kenë të gjitha të drejtat si pjesëtarët e tjerë të shoqërisë. 37.9 përqind e të anketuarëve e aprovojnë këtë qëndrim, përkundër 28.4 përqind që kanë mendim të kundërt. Në këtë kategori saktësisht 1/3 e të anketuarëve, ose 33.7% nuk e kanë deklaruar mendimin.

Nga kjo mund të shihet se ka një prishje të ekuilibrit tepër të madhe në mes aprovimit të qëndrimeve negative dhe atyre pozitive në raport me pjesëtarët e komunitetit LGBT, me çka mund të flitet lirisht për një dominim të homofobisë në shoqerinë kosovare. Ndër ata që parimisht janë të vetëdijshëm se homoseksualiteti është diçka e lindur dhe që ka ekzistuar gjithmonë, dhe që nga ana tjetër e dijnë se të drejtat e njeriut duhet të vlejnë për të gjitha grupet shoqërore, përkrahja e këtyre qëndrimeve pozitive bie ndesh me stereotipet dhe paragjykimet homofobe. Kjo situatë ua krijon një ambivalencë të tipit, "po, homoseksualët janë të tillë për nga natyra, por shoqëria dhe shteti nuk mund të tolerojnë manifestimin e hapur të tij sepse ky megjithatë është një perversitet!"

Ashtu sikur që te bindjet fetare njihet si e tillë ekzistenca e djallit, por kërkohet kundërshtimi i nxitjeve të tij që çojnë në degjenerimin e shoqërisë, edhe te pjesa e të anketuarëve që pajtohen se homoseksualët lindin të tillë, ose që kanë ekzistuar gjithmonë, paraqitet refleksi paragjykues i refuzimit të tij si dukuri antishoqërore dhe "djallëzore".

## **Roli i nivelit të edukimit në ndërtimin e opinioneve pozitive dhe negative**

Duke u nisur nga supozimi se edukimi i të anketuarëve mund të ketë ndikim në opinionet e tyre rreth homoseksualitetit, kemi analizuar pyetjet që testojnë qëndrimin ndaj komunitetit LGBT nga ky aspekt, se a ndikon niveli i edukimit në nivelin e paragjykimeve. Dy tabelat e mëposhtme tregojnë se mes tri grupave ka dallime të mëdha në perceptimet, sidomos ndërmjet të të anketuarëve me shkollim të ultë dhe të mesëm, dhe atyre me përgatitje universitare e më lartë. Përkundër kësaj, ka edhe disa kundërthënie p.sh. te përgjigja e të anketuarëve me edukim të lartë në pyetjen nëse homoseksualët lindin si të tillë, më shumë ka përgjigje negative, 28.6% sesa pozitive 23.3%, ndërkaq që te ata me shkollë të mesme është e kundërtë (60.6% me 53.6%).


QËNDRIMET NEGATIVE NDAJ LGBT / PËRGJIGJET SIPAS NIVELIT TË EDUKIMIT		PA SHKOLLË DHE FILLORE		E MESME		UNIVERSITET, MASTER, DR.	
		PO	JO	PO	JO	PO	JO
1. Homoseksualiteti është sëmundje		17.7	12.3	60.3	55.9	21.9	31.7
2. Homoseksualiteti e rezikon shqërinë		19.5	9.7	57.3	58.6	23.2	31.7
3. Homoseksualiteti duhet të ndalohet me ligj dhe të ndeshkohet		19.7	11.0	59.3	58.5	21.0	30.5
4. Homoseksualitetin e ka krijuar Perëndimi		22.8	13.7	57.4	59.9	19.7	26.4
5. Nuk duhet të lejohen kurssesi martsat mes homoseksualëve		19.7	13.2	57.1	52.4	23.2	34.5

QËNDRIMET POZITIVE NDAJ LGBT / PËRGJIGJET SIPAS NIVELIT TË EDUKIMIT		PA SHKOLLË DHE FILLORE		E MESME		UNIVERSITET, MASTER, DR.	
		PO	JO	PO	JO	PO	JO
1. Homoseksualët lindin si të tillë		16.1	17.8	60.6	53.6	23.3	28.6
2. Nuk kam problem që të shqërohem me homoseksualë		16.0	18.5	53.8	61.5	30.2	20.0
3. Personave LGBT duhet t'u lejohet adoptimi i fëmijëve		16.0	18.4	52.0	57.3	32.0	24.4
4. Homoseksualët duhet t'i kenë të drejtat e njëjtë		14.7	21.6	56.9	55.3	28.4	23.1

## Diskriminimi dhe dhuna ndaj komunitetit LGBT

Jo vetëm në rastin e ushtrimit të dhunës ndaj grupit të Revistës Kosovo 2.0, që ndodhi kohë më parë, por në vazhdimësi raportohet me raste të dhunës dhe diskriminimit ndaj pjesëtarëve të komunitetit LGBT. Këto raportime më shumë bëhen në nivelin e komunikimit shoqëror, sesa në mediume ose institucionale.

Si rezultat i faktit se mediat dhe institucionet tjera pothuajse fare nuk merren me raportime të tillë, hulumtimi ka evidentuar se një përqindje e theksuar e të anketuarëve kosovarë nuk e dijnë nëse ka apo nuk ka dhunë ndaj homoseksualëve (32.7%) ose kanë refuzuar që të përgjigjen (5.7%). Te të anketuarit, më i përhapur është opioni se dhuna ndodhë, por se këto janë raste të izoluara (26.4%), derisa përgjigja se dhuna ndodh shpesh është e nivelit më të ulët (18.9%).



#### **6. A ka diskriminim dhe dhunë ndaj komunitetit LGBT?**


Te ky diagram bie në sy përqindja e vogël e atyre që mohojnë praninë e dhunës ku për opcionin se dhuna nuk ndodhë asnjëherë janë deklaruar 12.9 përqind të të anketuarëve, kurse për përgjigjen se dhuna ka ekzistuar më herët dhe sot më nuk është e pranishme janë deklaruar 3.4%.

Është pra e dukshme se vetëm një pakicë e vogël prej rreth 1/6 e mostrës mohon dhunën ndaj homoseksualëve, kurse gati gjysma e pohon këtë. Kështu, nëse supozohet se ndër ata që nuk kanë dashur të përgjigjen, duhet të ketë një numër të konsiderueshëm që në mënyrë të heshtur e pranojnë praktikimin e dhunës, ky rezultat i hulumtimit mund të merret si provë se shoqëria kosovare është e vetëdijshme për shkallën e lartë të diskriminimit dhe dhunës ndaj homoseksualëve. Si pasojë, pasi që në këtë shoqëri dominon paragjykimi homofob, më shumë ka prirje që kjo dhunë të arsyetohet, sesa të dënohet dhe të distancohet nga ajo.

#### **Shkalla e homofobisë**


Në këtë hulumtim nuk e kemi përdorur shkallën e plotë të Bogardusit për matjen e distancës sociale ndaj pjesëtarëve të komunitetit LGBT, por të shkurtuar në dy pyetje, sa do të ishin të shqetësuar nëse do të kuptionin se një koleg i punës ose mik është homoseksual, dhe sa do ishin të shqetësuar nëse do të kuptionin se një anëtar i familjes së tyre është homoseksual.

Të anketuarit janë lutur që shkallën e shqetësimit ta vlerësojnë me nota prej 1 (tejet i shqetësuar) deri në 10 (aspak i shqetësuar).



#### 7. Si do të ndiheshit nëse do të kuptonit se një koleg i punës është homoseksual?


Përgjithësisht, për të dy kategoritë vlerësimi refuzues ose homofobia është e shkallës shumë të lartë. Në pyetjen për kolegët/miqtë te mostra reprezentative e Kosovës 58.9 përqind kanë dhënë notat 1 ose 2, dhe 15.1 përqind notat 3 dhe 4, në total kjo përbënë 74 përqind të të anketuarëve. Johomofobët që kanë vlerësuar me nota 7 dhe 8 janë 6.9 përqind dhe tejet johomofobë me nota 9 dhe 10 janë 2 përqind, ose gjithsejt 8.6 përqind. Në kategorinë që e kemi quajtur "indiferent" (notat 5 dhe 6) janë 13.3 përqind.



#### 8. Si do të ndiheshit nëse do të kuptonit se një koleg është homoseksual (nota mesatare)?

Të ngjashme janë vlerësimet edhe për mostrën e shqiptarëve dhe të pakicave. Nota mestare e totalit të mostrës për kategorinë koleg/mik është 2.8 përqind në nivelin e Kosovës, 2.9 përqind te mostra shqiptare dhe 2.7 përqind te mostra e pakicave.


Në pyjeten e dytë që ka matur shqetësimin nëse një anëtar i familjes tregon se është homoseksual, homofobia shfaqet në nivelin edhe më të lartë. Te mostra reprezentative e Kosovës, 82.5 përqind kanë dhënë notat 1 ose 2, dhe 5.6 përqind notat 3 dhe 4, në total kjo përbënë 88.1 përqind të respondentëve. Johomofobët që e kanë vlerësuar me nota 7 dhe 8 janë 2.0 përqind dhe tejet johomofobë me nota 9 dhe 10 janë 3.6 përqind, ose gjithsejt 5.6 përqind. Në kategorinë që e kemi quajtur "indiferent" (notat 5 dhe 6) janë 4.9 përqind. Në diagram është edhe një tregues i atyre që kanë refuzuar që të përgjigjen dhe të tillë janë 1.4%.



#### 9. Si do të ndiheshit nëse do të kuptonit se një anëtar i familjes është homoseksual?

Të ngjashme janë vlerësimet edhe për mostrën e shqiptarëve dhe të pakicave. Nota mestare e totalit të mostrës për kategorinë anëtar i familjes është 1.8 për qind në nivelin e Kosovës, 2 për qind te mostra shqiptare dhe vlerën më ekstremisht homofobike prej 1.3 për qind e gjejmë te mostra e minoriteteve.

Mund të konkludohet se shkalla e homofobisë bëhet më e lartë sa më shumë që i afrohet rrerhit shoqëror dhe sidomos familjes së të anketuarëve. Praktikisht, në Kosovë vetëm çdo i 20-i i anketuar është johomofob, kurse 19 të tjerë shfaqin simptome të homofobisë së shkallëve të ndryshme, shumica të homofobisë ekstreme.



**10. Si do të ndjeheshit nëse do të kuptonit se një anëtar i familjes tuaj është homoseksual (nota mesatare)?**


## Bartësit kryesorë të homofobisë në Kosovë

### Homofobia te besimet fetare

Sa i përket vlerësimit të dhunës ndaj homoseksualëve nga perspektiva e besimtarëve fetarë, shumica e të anketuarëve të besimit katolik mendojnë se kjo dhunë nuk ndodhë asnjëherë (52.9%), ndërsa dukshëm më pak këtë vlerësim e kanë edhe të anketuarit e besimit mysliman (22.2%).


Vlerësimi tjetër se dhuna ndaj homoseksualëve është një dhunë e shpeshtë haset te shumica e të anketuarëve të besimit ortodoks (58.8%), derisa dukshëm më i ulët në përqindje, ky vlerësim shfaqet te të anketuarit myslimanë (26.6%). Këta të fundit më shumë e përkrahin vlerësimin se dhuna ndaj homoseksualëve është e rastësishme dhe me raste të izoluara (44.8%), gjë qe e bëjnë edhe 38.2 përqind e të anketuarëve ortodoksë.

Nga këta tregues mund të konstatohet se në pikëpamje fetare, pranimi i prezencës së dhunës ndaj homoseksualëve më shumë është i shprehur te besimtarët ortodoksë kosovarë, më pak tek ata myslimanë, e dukshëm më pak tek ata katolikë. Megjithatë, kjo nuk duhet të përkthehet me automatizëm në shprehje të vetëdijësimit të veçantë shoqëror të besimtarëve të këtyre konfesioneve ndaj homoseksualëve. Për shkallën relativist më të lartë të deklarimit të dhunës të besimtarët ortodoksë, mendohet të ketë pasë ndikim mediatizimi shumë i gjërë i Paradave të Krenarisë në disa vite të fundit në Beograd, të cilat u patën ndaluar nga pushteti i atjeshëm. Dihet se mediat elektronike dhe shtypi i Beogradit përcillen intensivisht në mijediset ku



### 11. A ka diskriminim dhe dhunë ndaj komunitetit LGBT?

jetojnë serbët e Kosovës, dhe se ato janë burimi kryesor i informimit të tyre. Hulumtimi gjithashtu ka evidentuar një shkallë të lartë korrelacioni në mes përkatësisë në grupet konfesionale që janë aktivë në praktikimin e fesë, nga njëra anë, dhe nivelit të homofobisë, nga ana tjetër. Kështu, në nivel të Kosovës 90.1 përqind e të anketuarëve që janë deklaruar besimtarë aktivë kanë shprehur qëndrime homofobe. Te të anketuarit shqiptarë, ky nivel është në kuotën prej 89.6 përqind, ndërsa te të anketuarit nga pakicat është vetëm pak më e ulët, 86.6 përqind.




### 12. Homofobia ndër besimtarët aktivë dhe jo besimtarët

Tek ata që janë deklaruar jobesimtarë, në nivel të Kosovës, shkalla e homofobisë është më e ulët se ajo te besimtarët, por përsëri mbetet në nivele të larta (55.4%), ndërsa te këta vërehet një nivel më i lartë i indiferencës ndaj homoseksualitetit (20.5%), si dhe i johomofabisë (24%).

E njëjtë gjë duket edhe në dallimet në mes të shqiptarëve dhe pjesëtarëve të pakicave.

E tërë kjo lë të kuptohet se feja përbën njërin prej burimeve më të rëndësishme të homofobisë, si dhe paragjykimeve dhe stereotipeve mbi homoseksualitetin. Bartësit e homofobisë kryesisht janë besimtarë aktivë që konsiderojnë se homoseksualiteti bie në kundërshtim me kodin e moralit fetar, i cili konsiderohet si udhërrëfyesi ekskuluziv i jetës individuale dhe shoqërore.




### 13. A duhet personat homoseksualë t'i kenë të gjitha të drejtat sikur të tjerët?

Si dy tregues shtesë për ndikimin e besimeve në homofobi kemi marrë edhe përgjigjet e besimtarëve aktivë të të trija konfessioneve në pyetjen se “a duhet personat LGBT t'i gjëzojnë të drejtat e njëta sikurse të tjerët?” dhe konstatimin “feja është e vetmja rrugë e drejtë”.

Në pyetjen për të drejtat, në totalin e mostrës së Kosovës, 58.9 përqind e të anketuarëve kanë deklaruar se të drejtat për homoseksualët duhet të janë të barabarta me ato të qytetarëve të tjerë, te mostra e shqiptarëve kështu janë deklaruar 50 përqind dhe te mostra e pakicave vetëm 25.8 përqind.

Kryqezimi tjetër i të dhënave të mbledhura tregon korelacionin mes praktikimit aktiv të konfessionit dhe deklarimit se “feja është e vetmja rrugë e drejtë”, si indikacion i bindjes se besimi është vlerë ekskluzive dhe dominuese për njeriun. Në këtë kontekst, 80 përqind e të anketuarëve shqiptarë dhe 66.7 përqind e të anketuarëve nga pakicat, që besojnë se feja është e vetmja rrugë, kanë deklaruar qëndrime homofobe.




#### **14. Feja është e vëtmja rrugë e drejtë**

Vetëm 20 përqind e të anketuarëve shqiptarë që kanë këtë vlerësim për fenë janë deklaruar indiferentë ndaj homoseksualitetit, dhe 33 përqind nga pakicat që kanë të njejtin vlerësim kanë deklaruar qëndrime johomofobe. Por, duhet të kihet parasysh se këto vlera, sidomos për të anketuarit nga kategoria e pakicave që në anketë janë përfshirë në numër shumë të vogël, shkalla e gabimit të mundshëm statistikor është shumë e lartë, dhe ato duhet të merren si indikacione potenciale për të cilat duhet siguruar prova nga humumtime tjera që ose janë më të detajuara dhe zbërthejnë motivet shtesë të perceptimeve, ose bazohen në mostra më të mëdha që e zgjedhjnë dukshëm mundësinë e “gabimeve statistikore”.

### **Homofobia dhe partishmëria**

Partitë politike të sotme zakonisht karakterizohen nga diskursi i vazhdueshëm afirmativ për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive individuale dhe njërezoze. Pothuajse të gjitha partitë politike në Kosovë shprehen se programet e tyre përbajnjë vlera perëndimore, liberale dhe demokratike. Humumtimi ka evidentuar se zgjedhësit e partive nuk mendojnë krejtësisht në përputhje me programet e partive të proklamuara për barazi të drejtash për të gjithë qytetarët, pavarësisht dallimeve që ata mund t'i kenë. Kryqëzimi i të dhënave për votuesit e deklaruar të partive, me qëndrimet që i kanë shprehur ata për homoseksualitetin, tregon shkallën e lartë të homofabisë nga ana e elektorateve, gjë që në përgjithësi homofobia dominon në Kosovë.

Kështu, pro pikëpamjes se personat homoseksualë duhet t'i gjelqinë të



#### 15. A duhet homosekualët t'i kenë të gjitha të drejtat si të tjérët?


gjitha të drejtat sikurse të tjérët janë dekluar 64 përqind e të anketuarëve që kanë thënë se votojnë për PDK, 61.5 përqind e atyre që votojnë për Lëvizjen Vetëvendosje, 61.8 përqind e atyre që votojnë AAK dhe 50.5 përqind e atyre që votojnë LDK-në.

Pjesa tjeter e të anketuarëve nga partitë politike janë shprehur kundër barazisë së të drejtave për homoseksualët. Ky tregues lë të kuptohet se përkundër retorikës liberale dhe demokratike, elektoratet e të gjitha partive politike në Kosovë nuk janë krejtësisht të çliruara nga ndjenjat dhe qëndrimet homofobe.

Këtu vlen të permendet se shkalla më e lartë e homofobisë evidentohet te të anketuarit që kanë deklaruar se janë në LDK (49.9%). Kjo ndoshta mund të shpjegohet me faktin se LDK e promovon veten si parti politike e djathtë, me ide dhe vlera tradicionale dhe konservatore. Tradicionalizmi dhe konservativizmi ideologjik përbën një burim të rëndësishëm të homofobisë edhe në vendet tjera. Duhet cekur se në Kosovë, sikurse në vende tjera të botës postkomuniste, pjesa dërmuese e partive po kështu deklarohen me orientim të djathtë, ose si qendër e djathtë, kështu që krijohet konfuzion se cila është e djathta e vërtetë, dhe cila falce ose e modës.

#### “Antiperëndimorët”, BE-ja, demokracia dhe homofobia

Në shoqërinë kosovare, prej kohësh dominon mendimi se ne jemi shoqëri europiane, që synojmë një ditë të bëhem i pjesë e Bashkimit European.



#### **16. Duhet të kemi kujdes nga ndikimi i perëndimit**


Në anën tjetër, Kosova është edhe shtet sekular, me një kushtetutë të standardeve të larta të demokracisë liberale. Ky orientim shpeshherë kritikohet nga grupacione të ndryshme, të cilët konsiderojnë se vlerat e perëndimit janë të rrezikshme për shoqërinë kosovare dhe se për këtë shkak duhet të jemi të kujdeshëm ndaj Perëndimit dhe vlerave që na vijnë prej tij.

Rëndom këto ide qarkullojnë nëpër forume dhe qarqe të caktuara që promovjnë vlera dhe ide fundamentaliste islame. Në këtë hulumtim pasqyrohet qartë se tek ata që deklarojen si antiperëndimorë, homofobia shfaqet në shkallën e lartë. Hulumtimi evidenton se 88.1 përqind e të anketuarëve shqiptarë që kanë qëndrim kritik ndaj perëndimit janë homofobë, vetëm 9 përqind e tyre janë johomofobë dhe 3 përqind janë indiferent ndaj homoseksualitetit.

Në rastin e pakicave, hulumtimi ka evidentuar një shkallë të plotë të homofobisë tek ata që janë kritikë të perëndimit (100%), mirëpo kjo kritikë, sidomos te qytetarët serb, nuk ka të bëjë vetëm me kritikën morale ndaj perëndimit, por është e lidhur me intervenimin e NATO-s të vitit 1999, intervenim që dëboi shtetin e atëhershëm serb nga Kosova.

Ndonëse është i kundërthënhëm në parim, hulumtimi ka evidentuar edhe një shkallë mjaft të lartë korrelacioni në mes homofobisë jo vetëm nga të anketuarit që janë deklaruar se kanë qëndrim kundër integrimit në Bashkimin European, por edhe nga ata që janë pro integrimit në BE.


Është interesante se shkalla e johomofobëve është më e lartë te të anketuarit pro BE të pakicave (19%), sesa te shqiptarët (9.8%) dhe mostra e përgjithshme kosovare (10.2%). Ndërkaq te kategoria anti BE, vlera më e lartë e johomofobëve, në përpjestimet relative, është ajo te të anketuarit shqiptarë (21.4%).




#### 17. Kosova nuk duhet të bëhet anëtare e BE-së

Në anën tjetër, homofobia kap nivele edhe më të larta tek ata të anketuar që mendojnë se Kosova nuk duhet të bëhet pjesë e Bashkimit European. Kështu në nivel të Kosovës, 88 përqind e tyre kanë deklaruar qëndrime homofobe, 78.5 përqind e të anketuarëve shqiptarë dhe 100 përqind e të anketuarëve nga pakicat.

E njëjta situatë paraqitet edhe tek ata të anketuar që besojnë se Kosova e ka vendin në BE, me homofobi të shprehur në shkallët e larta: në nivel të



#### 18. Shkalla e homofobisë ndër të anketuarit pro-perëndimorë




#### **19. Homofobia te të anketuarit antidemokratikë**

Kosovës 76.3 përqind, te të anketuarit shqiptarë 75.3 përqind dhe pakicat 90 përqind.

Tregues të tillë mund të shpjegohen me faktin e njohur sociologjik se qytetarët e rëndomtë gjithmonë përvetësojnë qëndrime dhe besime të cilat mund të janë në kundërshtim me njëra tjetrën.

Qytetarët e zakonshëm rëndom nuk e shqyrtojnë koherencën logjike të bindjeve dhe qëndrimeve të tyre.



#### **20. Homofobia te të anketuarit pro-demokratikë**


Hulumtimi ka prekur edhe çështjen e rapportit në mes qëndrimeve homofobe, në një anë, dhe atyre antidemokratike dhe pro demokratike, në anën tjeter. Rezultati i evidentuar është se nuk ka dallime të rëndësishme në qëndrimin ndaj homofobisë në mes të të anketuarëve që kanë bindje demokratike dhe atyre me bindje antidemokratike. Në Kosovë, si demokratët (74.2%) ashtu edhe antidemokratët (73.6 përqind) janë homofobë. Edhe ky korrelacion flet për qëndrimet kontradiktore që shfaqen në mesin e qytetarëve kosovarë.

## **Disa dimensione të homofobisë**

Duke kryqëzuar deklaratat e të anketuarëve që janë identifikuar me qëndrime dhe prirje homofobe, me pyetjet specifike që kanë të bëjnë me perceptimet e trajtimit të komunitetit LGBT në Kosovë, kemi nxjerrë disa tregues të rëndësishëm për ndërtimin e një profili më të detajizuar të homofobisë në shoqërinë kosovare.

## **Homofobia dhe dhuna**


Të anketuarit homofobë janë shumë më të prirur që të mohojnë se diskriminati dhe dhuna ndaj homoseksualëve është dukuri e shpeshtë (Kosova 88.3%, shqiptarët 84.3% dhe pakicat 71.4%), sështë pohojnë që kjo dukuri ekziston (Kosova 50.1%, shqiptarët 58.8% dhe pakicat 77.8%).



**21. Dhuna ndaj personave LGBT ndodh shpesh**

Proporcionet dalin të kundërta, edhe pse në shkallën më të ulët, tek deklari-

met e të anketuarëve johomofobë. Për qëndrimin se diskriminimi dhe dhuna ndaj komunitetit LGBT në Kosovë ndodhin shpesh janë shprehur 24.9% të të anketuarëve kosovarë, 29.4% të atyre shqiptarë dhe 7.4% të pakicave.




**22. Dhuna ndaj komunitetit LGBT nuk ndodh asnjeherë**

Ndërkaq, prania e mohimit të diskriminimit dhe dhunës ndaj komunitetit LGBT te kategoria e të anketuarëve johomofobë paraqitet me vlera të përbysura (Kosova 6.6%, shqiptarët 4.8%, pakicat 28.6%).


## **Homofobia dhe autoritarizmi**

Të anketuarit, të cilët janë identifikuar si konservator dhe autoritar për nga bindjet, shfaqen si më homofobë në krahasim me të anketuarit e identifikuar si liberalë dhe jo autoritarë, siç pasqyrohet në diagimin vijues. Këtu, përmendimin se homoseksualët janë njerëz si të gjithë të tjerët, dallimi i qëndrimeve mes tipit autoritar dhe atij joautoritar në dy mostrat më të vëllimshme, është dukshëm në favor të barazisë (Kosova 77% krahas 63.3, shqiptarët 78% krahas 68.5%,).

Ndërsa te mostra e të anketuarëve minoritarë është e kundërtë: 41.2% deklaruan se homoseksualët janë si të gjithë të tjerët, kurse 58.8% se nuk janë të njëjtë. Në përgjithësi, dallimet nuk janë aq të mëdha te perceptimi i çështjeve të ndryshme lidhur me homoseksualitetin, ngase p.sh. në pyetjen nëse homoseksualiteti është sëmundje, dallimet mbresin por janë më të ulëta. Përgjigja PO te homofobët dhe johomofobët: mostra e Kosovës 35.2% me 41%, mostra shqiptare 57.6% me 59.1%, kurse te mostra e pakicave dominon bindja te autoritarët se homoseksualiteti është sëmundje në proporcionin 93.5% krahas 56.2% te jo autoritarët.



23. Homoseksualet janë njerëz si gjithë të tjeteret / vlerësimi (jo)autoritar




24. Homoseksualiteti është sëmundje / vlerësim (jo)autoritar

**A duhet të ndërmirren masa për përmirësimin e pozitës së komunitetit LGBT?**

Një nivel mjaft ekstrem i homofobisë dhe i refuzimit që të ndërmirret çfarëdo mase për përmirësimin e pozitës së komunitetit LGBT në shoqërinë kos-

ovare, është shprehur në përgjigjet që janë dhënë pyetjes në të cilën është kërkuar mendimi i të anketuarëve për disa masa të listuara si akte të mundshme që do të kontribuonin për realizmin e këtij qëllimi. Një e pesta, ose 19.9% e të anketuarëve të mostrës shqiptare kanë dekluaruar se janë kundër këtyre masave dhe kanë preferuar ndjekjen ligore dhe ndëshkimin e homoseksualëve.

Në mostrën e Kosovës kjo përqindje është pak më e ultë 18.7%, kurse te mostra e pakicave 12.1%.



25. Çfarë duhet bërë për përmirësimin e gjendjes së komunitetit LGBT?

Qëndrimet johomofobe shprehen gati në të njëjtin proporcion 17.3% te të anketuarit shqiptarë si përgjigje që favorizon masën e ashpërsimit të ligjeve që mbrojnë të drejtat e komunitetit LGBT. Në nivelin të përgjithshëm kosovar, ky opcion përkrahet nga 13.2% të të anketuarëve, kurse te pakicat me 9.1%.

Koordinimi më i mirë mes zbatuesve të ligjit dhe komunitetit LGBT nuk ka përkrahje të madhe (Kosova 6.2%, shqiptarët 3.4%, pakicat 2.3%)

Koordinimi më i mirë mes pushtetit dhe komunitetit LGBT ka përkrahje pak-sa më të madhe (Kosova 12.2%, shqiptarët 7.1%, pakicat 19.7%).


Përafërsisht i këtij niveli është edhe rekondimi i masës së trajnimeve më të shpeshta të zbatuesve të ligjit (Kosova 13.0%, shqiptarët 9.6%, pakicat 11.4%).

Kur jemi te pyetja e masave për përmirësimin e pozitës së komunitetit LGBT, është bërë edhe një diagram shtesë me kryqëzim të të dhënave për qëndrimin e të anketuarëve të identifikuar si fetarë aktivë me qëndrimin e tyre pozitiv dhe negativ rreth këtyre masave.

Përqindjet e prezantuara pasqyrojnë proporcionet e raportit numerik mes

besimeve fetare në Kosovë, andaj numrat për ortodoksët dhe katolikët, si dhe ateistët, janë në sasi të vogël, por në këtë rast na ka interesuar raporti brenda se cilës prej këtyre kategorive, se sa prej tyre janë pro masave përmirësim të pozitës, sa janë kundër, dhe sa ka që nuk kanë dashur të deklarohen.

Tek ateistët, të cilët janë shumë të pakët në përqindje, të gjithë të anketuarit sa janë 1.3%, janë deklaruar për fuqizimin dhe ashpërsimin e ligjeve që mbrojnë të drejtat e komunitetit LGBT. Te të anketuarit myslimanë, 30.7% janë kundër masave mbrojtëse dhe për ndëershkim, 32.1% për masat që do të përmirësojnë pozitën e LGBT, dhe 26.2% nuk e kanë deklaruar mendimin. Te të anketuarit katolikë, pak më shumë janë kundër masave dhe për ndëershkim 1.7%, sesa për mbrojtjen më të mirë ligjore të komunitetit LGBT. Të tillë janë 1.6%. Te komuniteti ortodoks, dallimi është pak më i theksuar, por në proporcione relative 1.5% për ndëershkim, 2.3% për mbrojtjen më të mirë ligjore të komunitetit LGBT.




26. Çfarë duhet bërë për përmirësimin e gjendjes së komunitetit LGBT?

## Vlerësimi i mediave

Vlerësimi i trajtimit të komunitetit LGBT në mediat e Kosovës nuk jep indikacione për rolin e mediave. Pak më shumë se një e katërtë e të anketuarëve mendojnë se mediat e trajtojnë komunitetin shkëlqyeshëm (10.1%) ose mirë (28.0%), në total pra janë 28.1 përqind që kanë mendim pozitiv për mënyrën se si e trajtojnë mediat komunitetin LGBT.

Po kështu, pak më shumë se një e katërtë e ndajnë opinionin se mediat kanë trajtim as të mirë as të keq (26.3%).

22.3 përqind të të anketuarëve mendojnë se media e trajton dobët (14.7%) dhe shumë dobët (7.6%) çështjen e komunitetit LGBT. 7.0 përqind mendojnë se nuk ka komunitet LGBT në Kosovë, kurse 6.3% nuk janë deklaruar.



27. Si vlerësohet trajtimi i komunitetit LGBT në mediat e Kosovës?

## **FOKUS GRUPI**

Pjesë e hulumtimit ka qenë edhe intervistimi dhe bashkëbisedimi i hapur në fokus grup, pjesë e të cilit ishin kryesish studentë të profileve të ndryshme universitare.

### **Rëndësia e debatit mbi tabunë e homoseksualitetit**

Bisedat në fokus grup kanë evidentuar qëndrime të ndryshme lidhur me debatin për komunitetin LGBT. Këto qëndrime ndryshojnë nga pikëpamjet sipas të cilave ky debat është i parakohshëm, ose i dorës së dytë, duke marrë parasysh faktin se shoqëria kosovare është e ngarkuar me probleme tjera shumë më të mëdha dhe nuk ka kohë të fokusohet në gjëra të tilla sekondare. Të tjerat janë pikëpamje që konsiderojnë se debati është i rëndësishëm dhe aktual për arsyen se çështja e komunitetit LGBT ka të bëjë me të drejtat e njeriut.

Si shembull i këtyre dy qëndrimeve mund të merren deklaratat e dy pjesë-marrësve në fokus grup, Rolandit dhe Tinës. Kështu, Rolandi deklaron se "është një temë e kotë me u marrë me homoseksualitetin, kur ke probleme tjera shumë më thelbësore pér vendin tonë". Në arën tjetër, Tina është e mendimit se kjo temë "nuk është problem sekondar, përderisa bëhet fjalë pér të drejtat kryesore të njeriut".

Në bisedat e fokus grüpuit, kur është fjalë pér debate mbi homoseksualitetin, evidentohet edhe fakti se shoqëria kosovare përgjithësisht ka njojur shumë të pakta mbi këtë dukuri, e cila deri diku mund të konsiderohet edhe si tabu. Kjo tabu thyhet vetëm në nivelin e bisedave joserioze miqësore. Kështu derisa Valentina shprehet se kjo temë është tabu, si rezultat i kësaj kemi faktin të cilin e potencon Donjeta në pohimin e saj se "mua më ka ra me diskutu me shoqni veç kur kemi bo hajgare. Përndryshe nuk e folim kurrë si temë serioze".

Ky tabuizëm ka krijuar gjendjen e një vakumi të madh informativ në opinionin publik, vakum i cili mbushet me përbajtje tjera si stereotipet dhe paragjykimet homofobe. Kjo gjendje më se miri artikulohet në mendimin e njërit prej pjesëmarrësve në fokus grup, Liridonit: "Në shkollë nuk mëson kurgjë, në media flitet pak ose hiç, familja nuk flet. Atëherë të rinjtë, të vëmet mënyra pér informim i kanë burimet fetare si xhamia dhe kisha. Me fjalë të tjera pjesa më konservative e shoqërisë flet pér homoseksualitetin dhe na mëson pér të. Mirépo, ata na mësojnë vetëm anët negative, pra informacioni është i njëanshëm. Përderisa nuk mundesh me marrë një informacion të balancuar, atëherë ti ke me u sherby vetëm me një anë të së vërtetës dhe sigurisht pjesa më e madhe e shoqërisë ka me urrejt ose me e paragjyku homoseksualitetin... Për me pas një opinion të drejtë dhe me kriju mundësinë me e largu këtë tabu, duhet me fillu me edukim përmes medias dhe shkollës. Kjo e merr një kohë pak më të gjatë se që na po mendojmë se mundemi me zgjidhë problemin. Duhet kohë e gjatë që njerëzit në Kosovë me fillu mos me i paragjyku këta njerëz dhe me i pranu si pjesë të barabartë të shoqërisë".

## **Dhuna ndaj Revistës Kosovo 2.0 dhe organizatës Libertas. Qëndrimet ndaj homoseksualitetit**

Bisedat në fokus grup kanë evidentuar përgjithësisht një qëndrim kritik ndaj organizatorëve të dhunës ndaj promovimit të Revistës Kosovo 2.0 dhe ndaj organizatës Libertas. Këta organizatorë ndërlidhen me qarqe të prirura nga radikalizmi fetar islam.

Përmendet si fakt se derisa këto qarqe nxisin homofobinë, si diçka që frymëzohet nga vlerat dhe morali i shoqërisë, në anën tjetër “përmes përfaqësuesve të tyre në Kuvendin e Kosovës nuk kanë bërë asgjë për të ndaluar miratimin e Ligjit për Hoqën e Madhe dhe Ligjin për Prizrenin, ligje që kanë më shumë ndikim në shoqërinë tonë se sa një grup i homoseksualëve, që ka qenë në fakt vetëm promovimi i një reviste” (Rolandi).

Dhuna konsiderohet si diçka e papranueshme, kur në bazë të kushtetutës “njëjtë sikur ne qe i kemi të drejtat tona, edhe ata (komuniteti LGBT) duhet me qenë të lirë dhe jo me mendu që nesër del një “mysliman” dhe i rrahë” (Tina).

Sa i përket qëndrimit ndaj dukurisë së homoseksualitetit, ato duket të jenë më të shumta. Në rradhë të parë konsiderohet se kjo dukuri është e përhapur në të gjithë botën. Liridoni sjell si shembull një sondazh ndërkombëtar ku rezulton se “përqindja e homoseksualëve në vendet perëndimore dhe në vendet islame është e njëjtë, por myslimanët nuk guxojnë me shprehë orientimin e tyre”, ndërsa në rend të dytë konstatohet ekzistencë e vazdueshme e kësaj dukurie edhe në shoqërinë kosovare. Rita sjell si shembull rrëfimin e gjyshit të saj, sipas të cilit “kjo dukuri ka ekzistu qysh moti”. Sa i përket dimensionit biologjik të fenomenit evidentohen qëndrime nga ato që thonë se “homoseksualiteti është i lindur” (Rolandi), e deri te qëndrimet si pas të cilave homoseksualiteti është një përvojë e fituar gjatë jetës (Liridoni).

Sa i përket anës shoqërore dhe personalitetit të homoseksualëve, bashkëbiseduesit që rrëfejnë situatat e komunikimit me ta, vlerësojnë se nuk kanë pasë ndonjë ndryshim në njellje te veprimet e tyre në raport me njerëzit e tjera, e që do të mund t'i kishin shokë, por jo edhe pjesëtarë të familjes.

Si shembull ilustrativ mund të merret deklarata e Ritës ku ajo thotë se “shoqen e kuptoj, po vëllaun s'e kisha kuptu”, por edhe shembulli i Valonit, i cili rrëfen se ka një shok gej me të cilin rrin, luan futboll, komunikon pa asnjë lloj problemi, por nuk mund ta konceptojë që një tolerancë të tillë mund ta ketë edhe nëse ndonjëri nga pjesëtarët e familjes së tij shfaq prirje homoseksuale. Ja opinioni i tij: “shoku jem i ngushtë mbetet shok i ngushtë. Pavarësisht se çfarë orientimi seksual ka, e kisha pranu”.

Nga kjo mund të konstatohet se, perveq qëndrimit publik tradicional homofob, në rrafshin e lidhjeve individuale kemi një qëndrim më tolerant ndaj homoseksualëve brenda hapësirës së rrethit shoqëror, dhe një qëndrim jo-tolerant ndaj tyre në hapësirën shoqërore të familjes. Mund ta kuptojë tjetrin, por jo veten. Kjo është një formë tjetër e homofobisë, që mund të kualifikohet si homofobi familjare. Një gjë e tillë mund të shpjegohet me faktin se në shoqërinë tonë vazhdon të dominojë koncepti tradicional dhe patriarkal për familjen.

## Ligjet dhe dhuna ndaj komunitetit LGBT

Ndonëse Kushtetuta e Republikës së Kosovës përmban dispozita shumë të qarta dhe mjaft të avansuara sa i përket të drejtave dhe lirive të njeriut në fushën e orientimit seksual të individit, ajo që mund të vërehet është se në jetën reale shoqërore, pjesëtarët e komunitetit LGBT ballafaqohen me forma të ndryshme të homofobisë aktive si përbuzja, marginalizimi shoqëror, dhuna fizike por edhe ajo strukturore.

Kjo pakicë shoqërore, ndonëse formalisht mbrohet nga kushtetuta dhe ligjet, realisht është e diskriminuar. Një gjë e tillë evidentohet edhe nga bashkëbiseduesit në fokus grup. Kështu Isufi, duke pohuar një shkallë të madhe të dhunës ndaj homoseksualëve, shprehet se “përveç dhunës fizike ka edhe dhunë psikologjike, që nganjëherë është edhe më e rëndë sesa ajo fizike”. Sipas tij, kjo bëhet edhe nga zyrtarë institucionalë ngase ai ka qenë vetë dëshmitar kur “pjesëtarët e policisë i kanë sulmu fizikisht”.

Faktin se homoseksualët ndihen të rrezikuar jo vetëm nga qytetarët e rëndomtë, por edhe nga zyrtarë institucionesh të ndryshme e pohon edhe Liridoni i cili rrëfen për një rast kur “pasi janë rrahë nga policia, janë dërgu në spital dhe mjekët nuk i kanë marrë me i shëru, me arsyetimin se janë të sëmurë psiqikisht”.

E tërë kjo flet për një nivel të lartë të diskriminimit dhe dhunës ndaj komunitetit LGBT. Kjo dhunë mund të ndahet në tri forma: dhunë fizike nga qytetarët e rëndomtë, dhunë rasti nga zyrtarë publikë dhe dhunë strukturore. Kjo e fundit duhet marrë në kuptimin se homoseksualët nuk kanë qasje të nejtë me të tjerët në jetën institucionale të shoqërisë.

## Vlerësimet për Paradën e Krenarisë

Një nga temat e trajtuara në fokus grup ka qenë edhe tema mbi mundësinë e organizimit të një parade të komunitetit LGBT në Prishtinë. Duke u nisur nga incidenti i ndodhur gjatë dhjetorit me promovimin e Revistës Kosovo 2.0, ku pati dhunë të hapur, bashkëbiseduesit janë përgjithësisht skeptik se një paradë e tillë mund të mbahet edhe në Kosovë. Në një rast të tillë, rreziku i një dhune edhe më të madhe do të ishte shumëfish më i lartë ngase “ka dalë një debat për seksin dhe është ushtru dhunë ndaj atyre njerëzve që e kanë organizu atë promovim, atëherë illogarit nese kishin dalë 50 veta dhe kishin thanë “na jena gej”, çka kish ndodhë” (Liridoni). Një gjë e tillë do të mund “të përfundonte tmerrshëm” (Rolandi). Këtë situatë, sipas bashkëbiseduesëve, e kupton edhe vetë komuniteti LGBT, prandaj edhe nëse do të kishte një thirrje për paradë “asnë prej tyre s’kish me dalë sepse nuk guxojnë” (Valoni), prandaj “për paradë duhet me u bo disa hapa të mdhenj në drejtim të forcimit të identitetit të vendit” (Rolandi), në kuptimin e avansimit të standardeve europiane në shoqërinë kosovare.

Në këtë kontekst dominon opioni se shoqëria kosovare ende nuk është e gatshme që të reagojë paqësishë ose me indiferencë ndaj një parade të tillë, për shkak se homofobia aktive vazhdon të jetë e gjithëpranishme në shumicën e niveleve të jetës shoqërore.

## Vlerësimet mbi përmirësimin e pozitës së komunitetit LGBT

Lidhur me mundësitë e përmirësimit të gjendjes ekzistuese në jetën shoqërore të pjesëtarëve të komunitetit LGBT, në bashkëbisedimin në fokus grup predominojn ideja për aplikimin e strategjive të vetëdijësimit, duke fillouar nga mediat, të cilat do duhej të hapin debate të thelluara të ballafaqimit të argumenteve të ndryshme shkencore dhe fetare, e pastaj edhe shkollat, ku do të mund të futej kjo temë edhe si pjesë e programeve të edukatës seksuale. Nuk përjashtohet tematizimi i saj edhe në kontekstin e jetës familjare, por, në mënyrë që kjo të ndodhë, duhet që “na së pari të luftojmë me marren e prindërve dhe fëmijëve. Se na nuk folim për seksin në fillim, e jo ma për homoseksualitetin” (Liridon). Mirëpo një gjë e tillë duket pak e realizueshme në kontekstin e një familjeje ku mentaliteti tradicional edhe dominon.

### **Konstatimet**

- Debat i mbi homoseksualitetin në Kosovë ka evidentuar tri lloj qëndrimesh mbi këtë dukuri: një qëndrim fetar homofob, një qëndrim liberal anti-homofob dhe një qëndrim ethnocentric homofob.
- Lidhur me rëndësinë dhe momentin e zhvillimit të debatit, vërehen pikëpamje të ndryshme, prej të cilave dallohen dy pikëpamje: njëra që kon sideron se ky debat është i parakohshëm dhe i dorës së dytë ngase Kosova ka probleme tjera shumë më të mëdha për të trajtuar dhe tjetra që potencon idenë se ky debat është mjaft i rëndësishëm dhe aktual ngase prekë në mënyrë direkte të drejtat dhe liritë e njeriut;
- Homoseksualiteti vazhdon të jetë një tabu e madhe në shoqërinë kosovare, qoftë në familje, në shkollë, në media apo edhe në nivele të tjera. Tematizimi i tij bëhet vetëm në formë të “humorit mes miqsh”, por jo edhe si çështje që meriton diskutim serioz e të thelluar;
- Sa i përket qëndrimeve ndaj homoseksualitetit në shoqërinë kosovare, në nivel të përgjithshëm dominon një qëndrim homofob, në rrafshin e raporteve ndërpersonale mund të vërehet një lloj tolerance ndaj homoseksualëve, ndërsa homofobia shfaqet shumë jotorante kur mendohet orientimi seksual i pjesëtarëve të familjes;
- Ekziston një dhunë e trefishtë ndaj Komunitetit LGBT në Kosovë: dhunë fizike nga qytetarët e rëndomtë, dhunë rasti nga zyrtarët publikë dhe dhunë strukturore;
- Lidhur me paradën e krenarisë, dominon opinioni se shoqëria kosovare ende nuk është e përgatitur që të reagojë ose paqësishët ose me indiferencë ndaj zhvillimit të një ngjarjeje të tillë;
- Për përmirësimin e pozitës së komunitetit LGBT në Kosovë, mendohet se rruga më e mirë është aplikimi i strategjive të vetëdijësimit në nivele të mediave dhe shkollave, duke mos përjashtuar edhe detabuizimin e kësaj teme edhe brenda familjeve.